



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna në Nenin 15, 26 dhe 31 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr.2004/9), të amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-080;
- Nenin 4 dhe 6 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Nenin 37 të Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqëritë Tregtare, dhe
- Aplikacionin për licencë furnizim/tregti me energji elektrike të bërë me datë 05.03.2010 nga ndërmarrja "ALPIQ ENERGIJA RS", adresa: Bulevar, Zorana Djindjica 64A, Beograd, Republika e Serbisë.

Në seancën e mbajtur me datë 05 gusht 2010, nxori këtë:

VENDIM

- I. **I LËSHOHET** licenca për furnizim/tregti me energji elektrike ndërmarrjes ALPIQ ENERGIJA RS, për periudhën nga data 05 gusht 2010 deri 05 gusht 2012.

Arsyetim

- ZRRE me datë 05 mars 2009 ka pranuar me postë të rregullt aplikacionin për licencë furnizim/tregti me energji elektrike nga ndërmarrja ALPIQ ENERGIJA RS.
 - Kjo zyrë ka vlerësuar aplikacionin e kompanisë në fjalë, dhe ka kërkuar plotësimin e dokumenteve që mungonin apo nuk përkonin me ato që kërkoheshin në Aplikacion.
 - Pas plotësimit të të gjithë dokumenteve dhe dëshmime të kërkuara sipas aplikacionit, ZRRE ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Licenca i lejon të licencuarit që të kryejë vetëm aktivitetin e **tregtisë** së energjisë elektrike në Kosovë.
 - III. Nëse i Licencuari ALPIQ ENERGIJA RS, dëshiron të zhvillojë edhe aktivitete të **furnizimit** me energji elektrike, të përcaktuara në Nenin 4 të licencës me Nr. ZRRE/Li_33/09, ai duhet të ri aplikojë, duke plotësuar kushtet që nevojitet për këtë aktivitet, sipas udhëzimeve të ZRRE-së.
 - IV. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.



V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar